



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 28.05.2025
Numër Protokolli: 3600/2025

A.nr.594/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.594/2025 të datës 03.04.2025 të parashtruar nga ankuesi SH.P, kundër Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.594/2025, e datës 03.04.2025 e parashtruar nga ankuesi SH.P.

II. Anulohet Formulari/njoftimi i datës 07.03.2025 për vlerësimet e rezultateve përfundimtare për pozitën “*Udhëheqës i Zyrë për Mbështetje Juridike* në Gjykatën Themelore në Ferizaj” të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës përmes konkursit Nr.01/2025 të datës 05.02.2025, ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *ri-vendosje* në fazën e verifikimit paraprak.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi SH.P. (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi) më datë 03.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli 2213/2025 nën shenjë A.nr.594/2025, kundër Njoftimit të datës 07.03.2025 për kandidatin e suksesshëm në konkursin “Udhëheqës i Zyrë për Mbështetje Juridike në Gjykatën Themelore në Ferizaj” të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 25.04.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës, ndërsa sipas kërkesës për prova kjo e fundit ka ofruar prova dhe sqarime shtesë me datë 25.03.2025. Kryetari i Këshillit, me datë 06.05.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:3042/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.594/2025 të datës 03.04.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2213/2025 të datës 03.04.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:3042/2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Formular i rezultateve të testit me shkrim; Formularin e rezultateve të kandidatit të suksesshëm i datës 07.03.2025; Njoftimin e datës 20.02.2025; Konkursin e datës 24.01.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.04.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 28.04.2025; Sqarimi i datës 23.04.2025 nga SKGJK; Vendimin e datës 30.01.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Vendimin e datës 24.01.2025 të Kryesuesit të SKGJK-së; Formularin e datës 18.02.2025 për verifikimin paraprak; Formularët e vlerësimit të testit me shkrim të datës 03.03.2025; E-mailin e datës 04.03.2025 dërguar nga B.G për anëtarët e komisionit; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 07.03.2025; Testet me shkrim të ankuesit dhe kandidatës fituese; Aplikacionin e punësimit i datës 10.02.2025 i ankuesit me dokumentacionin e bashkangjitur, Diplomën e datës 17.12.2012; Çertifikatën e datës 15.04.2019; Akt Emërimit e datës 29.04.2020; Marrëveshjen e datës 24.11.2015; Marrëveshjen e datës 05.01.2016; Marrëveshjen e datës 01.04.2016; Kontratën e datës 10.08.2016; Kontratë Shërbimi e datës 15.02.2017; Pasqyrë e llogarisë së trustit për ankuesin; Aplikacionin e punësimit i datës 10.02.2025 i kandidatës së suksesshme me dokumentacionin e bashkangjitur; Vërtetimin e datës 07.02.2025; Vërtetimin e datës 29.01.2020; Autorizim i datës 25.05.2018; Çertifikatë e datës 03.01.2018; Diplomë e datës 08.12.2016; Çertifikatë e datës 15.04.2019.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e **bazuar**, ndërsa lënda është kthyer në **rishqyrtim** dhe **rivendosje** në fazën e verifikimit paraprak, **sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, sipas vendimit nr.01/158 të datës 30/01/2025 me efekt të zbatimit nga data 24.01.2025 ka shpallë konkursin e pranimit (i brendshëm) për pozitën “Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Juridike” në Gjykatën Themelore në Ferizaj, me fillim të aplikimit

nga data 05/02/2025 deri më datë 11/02/2025 ndërsa bazuar në Renditjen Përfundimtare të kandidatëve konstatohet fakti se ankuesi ka arritur t'i mbledh 75.1 pikë duke u renditur i dyti në listë, rrjedhimisht nuk është përzgjedhur si kandidat fitues, ndërsa rezulton se kandidatja e suksesshme është V.H me gjithsejtë 82 pikë.

Ankuesi, e pakënaqur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit nga SKGJK, respektivisht njoftimit për kandidatin e suksesshëm, sipas udhëzimit në mjete juridike përmes aktit të kontestuar, me datë 03.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill me pretendimin ankimor se Komisioni i Pranimit ka qenë i themeluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ngase anëtarët e komisionit kane qenë të caktuar nga radhët e gjyqtarëve e jo sikurse e përcakton dispozita e lartcekur, me dyshimin e se komisioni përkatës nuk kanë qenë objektiv me rastin e vlerësimit të ankuesit, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e ankuesit ashtu që të ndryshoi listën e rezultateve finale apo që konkursi të kthehet në pikën zero.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit dhe rrjedhimisht vlerësimin e ligjshmërisë se procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse, Kolegji i Këshillit, fillimisht ju referua Konkursit me numër 01/2025 të shpallur me datën 05.02.2025 për pozitën “Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Juridike” në Gjykatën Themelore në Ferizaj, dhe si rrjedhojë konstatoi se kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar** Diplomë Universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti Juridik;
- **Provimi i Jurisprudencës** i vlefshëm në Kosovë;
- **Përvoja e punës** Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.

Kolegji i Këshillit, në mbështetje të dispozitave nga neni 2 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: “**2. Fusha e zbatimit**, 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë.”, andaj mori për bazë aktet veçanta të legjislacionit sekondar i nxjerrë nga Sekretari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, respektivisht dispozitat e aplikuara të nenit 2 të Rregullores Nr. 02/2024 Për Klasifikimin e Vendeve Të Punës Për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ku përcaktohet se: “Kjo rregullore përcakton kategoritë dhe klasat e nëpunësve civil të administratës në sistemin gjyqësor, përfshirë emërtesat e pozitave për çdo klasë, grupin, koeficientin, përshkrimin përgjithshëm për secilën kategori dhe klasë, procedurën dhe metodologjinë e klasifikimit pozitave të punës”, ndërsa me nenin 18 paragrafi 6, nën paragrafi 6.14 të së njëjtës rregullore, është përcaktuara se pozita Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Juridike/Gjykatë, hynë në kuadër të kategorisë Drejtues/e i/e Mesëm.

Po ashtu, me nenin 18 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 02/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, janë përcaktuar edhe çështjet e kërkesave formale, ku përcaktohet se: “Kërkesat e përgjithshme formale: arsimimi i kërkuar: 5.1 diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor); 5.2. kërkesat specifike: certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase; 5.3. përvoja e punës e kërkuar: së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.”, ndërsa lidhur me përshkrimin e detyrave të punës, Kolegji i Këshillit ka pranuar përshkrimin e detyrave dhe kriterëve të aprovuara për pozitën në fjalë, e që përputhen me ato të shpallura në konkursin e datës 05.02.2025 dhe paragrafi 5, neni 18 i Rregullores Nr. 02/2024 Për Klasifikimin E Vendeve Të Punës Për Nëpunësit Civil Në

Administratën e Sistemit Gjyqësor, dhe për rrjedhojë Kolegji i Këshillit kontestoi se konkursi i datës 05.02.2025 për pozitën “Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Juridike” është shpallur në pajtueshmëri me dispozitat e rregullores në fjalë për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Thënë si më lartë, dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 1 Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor ku përcaktohet se: “1. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i kriterëve, rregullave, themelimi i komisioneve, procedurave për rekrutim, vlerësimin, pranimin, emërimin dhe vlerësimin e punës provuere për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi. i 2. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga të gjitha palët e përfshira gjatë procedurës së rekrutimit, themelimit të komisioneve, vlerësimit, pranimit, emërimit dhe vlerësimit të punës provuere për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor. 3. Përfshirë paragrafit 2 të këtij neni, dispozitat e kësaj rregullore nuk zbatohen për pozitat: Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit, Drejtor i Njësisë për Inspektim Gjyqësor, Drejtor Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, administratorët dhe zëvendës administratorët e gjykatave si dhe bashkëpunëtorët profesional”, dhe konstatoi se dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për pozitën “Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Juridike” duke përfshirë edhe çështjen e kriterëve për themelimin e Komisioneve të Pranimit, e cila çështje në këtë procedurë administrative është kontestuar nga pala ankuese.

Andaj në referencë të konstatimit të dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, kur përcaktohet se: “2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtarë të rregullt dhe për secilën kategori të anëtarëve të komisionit caktohet një anëtarë zëvendësues në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë ku njëri nga ta caktohet Kryetar i Komisionit; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë.”, dhe konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar, pasi që sipas Vendimit të datës 30.01.2025 me numër:01/159 të Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, themelimi apo përbërja e Komisionit të Pranimit përbëhet prej gjyqtarëve, gjegjësisht sipas pikës I të dispozitivit të të njëjtit vendim, Komisioni i Pranimit është themeluar në përbërje prej shtatë (7) anëtarësh dhe që të gjithë gjyqtar, prej të cilëve pesë (5) anëtarë të rregullt, kurse dy (2) anëtarë rezervë, prandaj mbi këtë bazë dhe konstatimit të dhënë si më lartë, Komisioni i pranimit është themeluar në kundërshtim me paragrafin 2, nga neni 6 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ngase pozita për të cilën është zhvilluar konkursi nuk bënë përjashtim nga zbatimi i kësaj rregullore sipas nenit 1 paragrafi 3 të saj.

Prandaj, në mbështetje të nenit 2 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Kolegji i Këshillit pas konstatimit se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar ngase u konstatuan shkelje të dispozitave të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, nga neni 6 paragrafi 2, lidhur me themelimin dhe përbërjen e Komisionit të Pranimit, dhe në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të anuloi Formularin e datës 07.03.2025 të rezultateve përfundimtare nga testi me shkrim dhe intervista me gojë nga Komisioni i Pranimit, ndërsa konkursi i datës 05.02.2025 është kthyer në fazën e verifikimit paraprak me qëllim të kthimit të ligjshmërisë dhe evitimit të shkeljeve procedurale të konstatuara si në arsyetimin e këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se konkursin e datës 05.02.2025 nr.01/2025 e la në fuqi meqenëse konstatoi se i njëjti ishte shpallur në pajtueshmëri me dispozitat e akteve të veçanta, respektivisht të rregulloreve të nxjerra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore, obligohet që të veprojë në pajtueshmëri me dispozitat nga neni 16 paragrafi 1 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimi, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor ashtu që në ri procedurë të kryej verifikimin paraprak, ndërsa Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës duhet me marrë parasysh pikëpamjet juridike dhe konstatimet e dhëna si në këtë vendim, ashtu që Komisionin e Pranimi të jetë i themeluar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 6 paragrafi 2 ë së njëjtës rregullore të cekur si më lartë.

Andaj, pas konstatimeve të dhëna si më lart dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendim.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.594/2025, datë 28/05/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, SH.P;
- Kryetarit të Këshillit Gjyqësor;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës(Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njesisë të Burimeve Njerëzore);
- Arkivit të KPMSHCK-së.